VENDIM
Nr. 55, datë 26.3.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO LOGOS"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Logos", në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.7.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati